



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafit 1.27 dhe 1.14 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 5 paragrafit 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 16 maj 2017 miraton:

RREGULLORE NR.03/2017

PËR KOMISIONIN PËR ADMINISTRIMIN E PROKURORIVE

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton organizimin, përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, si Komisioni i përhershëm i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Neni 2

Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj Rregulloreje është mbikëqyrja e administrimit të prokurorive nga ana e Komisionit.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. "KPK" Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- 1.2. "Komision" Komisioni për Administrimin e Prokurorive;
- 1.3. "Sekretariat" Sekretariati i KPK

Neni 4

Përgjegjësitë e Komisionit

- 1. Komisioni për Administrimin e Prokurorive në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të veta bën:
 - 1.1. Përgatitjen dhe rekomandimin e politikave për administrim të prokurorive, përfshirë:

- 1.1.1. menaxhimin e rrjedhës së lëndëve përfshirë menaxhimin përmes sistemit elektronik;
- 1.1.2. menaxhimin e objekteve dhe pasurisë së prokurorive;
- 1.1.3. qasjes së publikut në prokurori dhe ngritjes së efikasitetit të shërbimeve të administratës;
- 1.1.4. unifikimin e praktikës së administratës në të gjitha prokuroritë e Kosovës, dhe
- 1.1.5. vlerësimin periodik të ngarkesës me lëndë nëpër prokurori, nevojën për prokurorë dhe staf shtesë si dhe specializimin e tyre.
- 1.2. Inspektimin e mbajtjes së regjistrave dhe evidencave në prokurori;
- 1.3. Krijimin dhe bashkërendimin e programeve dhe projekteve që kanë për qëllim përmirësimin e administrimit të prokurorive;
- 1.4. Mbikëqyrin dhe raportojnë në KPK për zbatimin e akteve normative, politikave dhe strategjive lidhur me administrimin e prokurorive;
- 1.5. Rekomandime rreth aktiviteteve dhe kërkesave të Njesisë për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë dhe Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve;
- 1.6. Me kërkesë të Këshillit, adreson çështje tjera lidhur me administrim të prokurorive;
- 2. Komisioni ka të drejtë që me qëllim të administrimit të prokurorive të themelojë grupe punuese.
- 3. Në punën e tij Komisioni bashkërendon punën edhe me komisionet e tjera të Këshillit për çështje të ndërlidhura.

Neni 5

Përbërja dhe mandati i Komisionit

- 1. KPK zgjedh anëtarët e Komisionit në përbërje prej tre (3) anëtarëve dhe atë si në vijim:
 - 1.1. Një anëtar i Këshillit i cili do të jetë Kryesues i Komisionit, dhe
 - 1.2. Dy anëtarë prokurorë.

2. Mandati i Kryesuesit të Komisionit zgjatë sa zgjatë mandati i tij në KPK, ndërsa mandati i dy anëtarëve prokurorë është pesë (5) vjet.

Neni 6

Përgjegjësitë e kryesuesit të Komisionit

1. Kryesuesi i Komisionit, përveç tjerash ka edhe këto kompetenca:
 - 1.1. Organizon punën e përgjithshme të Komisionit;
 - 1.2. Përgjigjet para Këshillit për veprimtarinë e Komisionit;
 - 1.3. Autorizon anëtarët dhe zyrtarët administrativ për ushtrimin e detyrave;
 - 1.4. Nënshkruan vendime, akte dhe shkresa të tjera;
 - 1.5. Planifikon programin e punës;
 - 1.6. Thërret mbledhjet dhe i udhëheq ato;
 - 1.7. Çdo 6 muaj përgatitë raport mbi punën e Komisionit;
 - 1.8. Përgatitë raportin vjetor dhe ia paraqet Këshillit për aprovim dhe
 - 1.9. Kryen punë të tjera të përcaktuara me Ligj, Rregullore dhe sipas kërkesës së Këshillit/Kryesuesit të Këshillit.
2. Në mungesë të Kryesuesit të Komisionit takimet e komisionit mund të udhëhiqen nga njëri nga anëtarët e Komisionit.

Neni 7

Mbledhjet e Komisionit

1. Mbledhjet e Komisionit i thërret Kryesuesi i Komisionit sipas planit vjetor të miratuar nga ana e Komisionit.
2. Komisioni mund të thërret edhe mbledhje të jashtëzakonshme varësisht nga nevojat e punës apo me kërkesë të KPK-së.
3. Kryesuesi i Komisionit cakton pikat e rendit të ditës dhe i njofton anëtarët e Komisionit me datën dhe vendin e mbledhjes, gjithashtu mund të ftojë në takim edhe ekspertë dhe partnerë të jashtëm.
4. Komisioni mbanë mbledhje sipas nevojës por jo më pak se një mbledhje në muaj.

5. Mbledhjet e Komisionit janë publike përjashtimisht rasteve për të cilat Komisioni vendosë të jenë të mbyllura.

Neni 8 **Kuorumi dhe marrja e vendimeve**

1. Komisioni mund të mbledhet nëse të pranishëm janë së paku dy anëtarë.
2. Vendimet e Komisionit merren me shumicën e votave.

Neni 9 **Mbështetja administrative për Komisionin**

1. Drejtori i Sekretariatit e cakton një zyrtar administrativ që të ofrojë mbështetje administrative për Komisionin.
2. Zyrtari administrativ në bashkëpunim me Kryesuesin e Komisionit dhe Drejtorin e Sekretariatit i kryen të gjitha veprimet e nevojshme administrative në mënyrë që puna e komisionit të jetë funksionale.
3. Me kërkesë të Komisionit, mbështetje administrative ofrojnë edhe stafi i Sekretariatit, stafi i prokurorive dhe stafi i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

Neni 10 **Kompensimi**

Anëtarët prokurorë të Komisionit do të kompensohen për punën e tyre në Komision mbështetur në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit.

Prishtinë, më 16 maj 2017


Blerim Isufaj
Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës